



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 8506/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12 paragrafi 2 shkronja d, 14, 40, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005 neni 9, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 25, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 09.11.2021 merr:

**VENDIM**

**PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT PËR PRONAT E PALUAJTSHME  
NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për caktimin e normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme, me përjashtim të kategorisë pronës publike të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
2. Normat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatimor 2022:

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
2	Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
3	Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
4	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
5	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
6	Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
7	Për njësitë komerciale të objekteve	0.20%
8	Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
9	Për njësitë industriale të objekteve	0.20%

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Tatimit në Pronë.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Tatimit në Pronë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 09.11.2021



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**



01/Nr.8488/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 09.11.2021 merr:

### VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar- Shtator 2021 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2021 është në shumë prej 2,520,165.91 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,686,554.11 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 1,197,301.43 € apo 72.45 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 223,744.83 € apo 63.35 %, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 40,135.78 € apo 59.90 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 60,255.00 € apo 75.05 % , në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 185,648.50 € apo 34.79 % dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2021 është në shumë prej 1,707,085.54 € apo 63.54 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 253,868.52 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Shtator 2021 apo 87.96% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje më shumë për 74,221.86 € apo 41.32%.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 09.11.2021







Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 7928/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 30, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 09.11.2021 merr:

**VENDIM**

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2022 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2022 për Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L "PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2022 për Ndërmarrjen Publike Lokale përban gjithsej 20 (njëzet) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 09.11.2021





01/Nr. 8714 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 neni 11 paragrafi 11.2, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 09.11.2021 merr:

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Bedri Bushi sipas kërkesës së tij.
2. Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 100 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Kollovozi" zona kadastrale Paldenicë, me kulturë arë e klasit të gjashtë (6), e evidentuar në emër të z. Bedri Bushi, sipas certifikatës pronësore P-73317066-01019-4.
3. Parcela e lartë shënuar gjendet në planin zhvillimor komunal dhe është në zonën ndërtimore, andaj u vendos që destinimi i pronës me kulturë arë e klasit të gjashtë (6), të bëhet parcelë ndërtimore.
4. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtim për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Parashtruesi i Kërkesës,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër,
- Drejtoria për Bujqësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 09.11.2021







Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr.8749/2021

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/ 15, qershor, 2008) Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, 01 nr.7703/2018 te dt. 25.10.2018, neni 11, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 09.11.2021 merr:

**VENDIM**

1. Miratohet Vendimi për pajisjet teknologjike për stafin politik, ekzekutivin dhe legjislativin e komunës, të cilët loptopët me pajisjet e tyre do t'i mbajnë si asete të tyre dhe nuk do të kthehen në komunë për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit.
2. Të gjithë Punëtorët e Arsimit, arsimtarët, drejtorët e shkollave, të cilët po ashtu janë të pajisur me loptop, do t'i mbajnë si asete të tyre dhe nuk do të kthehen në komunë për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit. Pjesë përbërëse e këtij vendim është lista e barkoreve dhe e numrit të loptopëve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financave.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Administratës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financave,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 09.11.2021

